



Hartimi i Politikave Zhvilluese në Shqipëri 2: "Zbatimi i Politikave dhe Planeve të Veprimit në Sektorin e Ujit"

Konteksti i projektit

Instituti i Kërkimeve Urbane është kontraktuar nga MPPTT për të përmbushur objektivat sic janë parashikuar në Termat e Referencës, e cila ngrihet në bazë të kontratës.

Objektivi kryesorë i projektit

Procesi i reformave administrative për Rishikimi dhe përmirsimi i Modelit ekzistues standart të Marrëveshjes së Performancës mes një ndërmarrjeje dhe zotëruesve të aksioneve të së njëjtës ndërmarrjeje. IKU në bashkëpunim me Ministritë e linjes, propozoi krijimin e një pakete me rregulla dhe instruksione, për institucionalizimin e zbatimit të Planit të Biznesit dhe Marrëveshjes së Performancës. Dokumenti do të shërbejë si guide dhe do të:

- Përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit të ndërmarrjes duke synuar arritjen e qëllimeve të parashikuar në PNAP në kohën më të shkurtër të mundshme;
- Përcaktojë objektivat dhe burimet e zhvillimit të ndërmarrjes;
- Përcaktojë rolin e Qeverisjeve Vendore, dhe të Ndërmarrjes, për arritjen e këtyre objektivave, dhe domosdoshmërinë për burime të tjera duke përfshirë investimet e huaja dhe të brendshme;
- Përcaktojë një kalendar të vecantë për uljen e subvencioneve nga Qeveria Qendrore tek ndërmarrjet por jo më pak se dhjetë përqind (10%) në vit, me qëllimin e nxjerrjes jashtë të subvencioneve operacionale të Qeverisë Qendrore gjatë katër viteve të ardhshme;
- Angazhojë NJQV dhe Ndërmarrjen të ulë deficitet operacionale në një masë korresponduese, por pa ulje të theksuara në cilësinë e shërbimit;
- Angazhojë NJQV për të ruajtur Fushën e Shërbimit të Ndërmarrjes për të paktën dy vjet në mënyrë që të shmangët një fragmentim i panevojshëm.

Aktivitetet

Aktiviteti 1: IKU asistoi pesë ndërmarrje te ujesjelles-kanalizimeve, dhe i ndihmoi ato që të zhvillojnë plane biznesi për zhvillimin dhe



përfundimin e Marrëveshjeve respektive të Performancës. IKU pergatiti draft marrëveshjet e performancës për secilën nga pesë kompanitë pilote dhe asistoi aktorët e tjerë të adoptojnë dhe nënshkruajnë atë sipas roleve dhe përgjegjësi që secila nga palët është e detyruar të luaj brenda zbatimit të saj

Aktiviteti 2: Rishikimi i mekanizmit aktual të grantit konkruues dhe sistemit të alokimit të investimeve kapitale në sektorin e ujësjellësit dhe asistimi e hartimi i Modelit për Skemën e Transferimit të Investimeve Bazuar në Performancë (TIP), e cila do të ndihmonte konsolidimin e rrjedhës së investimeve kapitale. Aty ku do të nevojitet, të amendohet skema aktuale e granteve konkruuese në Ligjin e Buxhetit të Shtetit dhe në Instruksionet respektive të Qeverisë për zbatimin e Ligjit të Buxhetit të Shtetit. IKU pergatiti dokumentet standarte të metodologjisë për përgatitjen e projekteve të reja për tu financuar nga TIP. IKU propozoi njëformule për alokimin e TIP, e cila do të ketë një komponent performance dhe një komponent jo performance, për të konsideruar:

- Pjesa e kriterëve të alokimit të bazuar në performancë duhet të vlerësojë performancën e ndërmarrjeve kundrejt objektivave të përcaktuar në Marrëveshjen e Performancës.
- Pjesa e kriterëve të alokimit jo të bazuar në performancë duhet të bazohet në nevojë, në sensin e fokusimit të investimit në vendet me nivelin më të ulët të mbulimit, me orët më të pakta të shërbimit, cilësinë më të ulët të ujit dhe/apo ku ekziston një varfëri;
- Do të propozohet një skemë për alokimin e subvencioneve, duke marrë në konsideratë psh, nevojën për subvencione

bazuar jo në performancë dhe boshllikun e mbetur për mbulimin e kostos operacionale dhe të mirëmbajtjes sipas planit për uljen e subvencioneve.

Metodologjia e IKU-s

- Përcaktimin nga një pikëpamje e ndjeshme analizuese e faktorëve kryesorë që duhet të konsiderojnë ndërmarrjet e ujësjellësit në mënyrë që të arrijnë objektivat e parashikuara në PNAP në kohën më të shkurtër të mundshme;
- Sugjerojë dhe përcaktojë kriteret kyç të performancës që do të konsiderohen të përdoren për të matur performancën e ndërmarrjeve të vecanta;
- Përgatisë metodologjinë për monitorimin e performancës së Kompanisë.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Banka Boterore / Ministria e Puneve Publike dhe e Transportit

KOHËZGJATIA:

2008

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti I Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Boterore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.